



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 270, datë 25.05.2023**

**PËR**  
**PROPOZIMIN PËR EMËRIM NË GJYKATËN E LARTË,**  
**TË KANDIDATES ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur më datë 25.05.2023, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e tij nr. 535, datë 17.11.2021, bazuar në rezultatet e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve, si dhe mbasi shqyrtoi projektvendimin “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatës znj. {...}”,

**VËREN:**

**I. MBI PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË TË GJYQTARIT**

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar edhe si Këshilli), sipas pikës 1, të nenit 136, si dhe shkronjës “c”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është organi kushtetues i ngarkuar me funksionin e propozimit Presidentit të Republikës të emërimit të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, nga radhët e gjyqtarëve dhe të juristëve të spikatur, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky funksion i Këshillit të Lartë Gjyqësor, përcaktohet edhe në pikën 2, të nenit 85, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

2. Ndërkohë, emërimi në Gjykatën e Lartë, sipas nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), konsiderohet si ngritje në detyrë, çka përbën një nga institutet e zhvillimit të karrierës gjyqësore, përgjegjës për të cilën është Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 86 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Neni 48 i Ligjit për Statusin përcakton se çdo pozicion i lirë në një gjykatë të një shkalle më të lartë ose të specializuar, plotësohet nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, nëse, kur është rasti, ky pozicion nuk arrihet të plotësohet nëpërmjet lëvizjes paralele. Në rastin e Gjykatës së Lartë, referuar kuptimit dhe përmbajtjes së institutit të lëvizjes paralele, ky instrument ligjor është i pazbatueshëm, sa kohë Gjykata e Lartë është gjykata e shkallës më të lartë në piramidën e organizimit të pushtetit gjyqësor, sikurse përcaktohet në pikën 1, të nenit 135, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sikurse edhe në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

4. Në kuadër të një procedure ngritjeje në detyrë, pra edhe atë të emërimit në Gjykatën e Lartë, sipas nenit 48, të Ligjit për Statusin, Këshilli i Lartë Gjyqësor është i ngarkuar me përgjegjësinë e verifikimit të plotësimit nga kandidatët të kriterëve të kandidimit, pra të emërimit në Gjykatën e Lartë, sikundër edhe për renditjen e kandidatëve që plotësojnë kriteret, në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, pra të kandidatit më të mirë për atë pozicion të lirë, për të cilin organizohet procedura e ngritjes në detyrë. Për renditjen e kandidatëve, sipas meritës, kjo dispozitë ligjore ka përcaktuar si kriter bazë atë të vlerësimit etik dhe profesional, i cili rregullohet nga nenet 68 e vijues, të Ligjit për Statusin.

5. Me Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, Këshilli plotësoi kuadrin ligjor në lidhje me procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore edhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, përfshirë dhe për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, që përbën dhe fazën e parë të procedurës së ngritjes në detyrë.

5.1 Ndërsa me Vendimin nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Këshilli plotësoi kuadrin ligjor në lidhje me procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve, pra renditjen e tyre dhe identifikimin e kandidatit të renditur më lart, që përbën dhe fazën e fundit të procedurës së ngritjes në detyrë.

5.2 Ndërkohë, në funksion të renditjes së kandidatëve, që sikurse u përmend më lart, si kriter bazë ka atë të vlerësimit etik dhe profesional, Këshilli miratoi Vendimin nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, si dhe Vendimin nr.264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, nëpërmjet të cilëve plotësoi kuadrin ligjor në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve.

6. Me synimin për plotësimin në kohë të pozicioneve të lira, ndër të tjera, edhe në Gjykatën e Lartë, kjo me qëllim për bërjen e kësaj të fundit funksionale në një kohë sa më të shpejtë, Këshilli, në të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat më të larta ose të specializuara, ka konsideruar zhvillimin paralelisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, me atë të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira. Kështu, për të filluar në kohë procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, çka do të mundësonte më pas përmbylljen e procedurës së përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, Këshilli konsideroi ndarjen në dy faza të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit. Në fazën e parë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit, pikërisht atyre të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në

fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, në logjikën sipas të cilës kandidati që nuk i plotësonte këto kritere do të duhej të skualifikohej nga kandidimi, duke mos u bërë kështu ai pjesë e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, pra për të lehtësuar këtë proces dhe synuar përfundimin në kohë të tij. Ndërsa në fazën e dytë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t’i nënshtroheshin verifikimit të kriterit të pasurisë dhe të figurës. Vetëm pas verifikimit të të gjithë kritereve të kandidimit, Këshilli do të vendoste përfundimisht për kualifikimin ose jo të çdo kandidati.

## **II. PROCEDURA E NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E LARTË, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS ADMINISTRATIVE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 535, DATË 17.11.2021, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

### **A. HAPJA E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË**

7. Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës) dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (neni 147/a, pika 1, shkronja “a”, i Kushtetutës), në kuadër të plotësimit të pozicioneve të lira në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, ndër të tjera, ka hapur procedurën e ngritjes në detyrë edhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative, shpallur me Vendimin e tij nr. 535, datë 17.11.2021.

8. Në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 535, datë 17.11.2021, afati i kandidimit u përcaktua deri më datë 17.12.2021.

### **B. KANDIDIMET**

9. Brenda afatit të kandidimit, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 535, datë 17.11.2021, kandiduan gjithsej 6 (gjashtë) kandidatë dhe konkretisht: z. Arjan Qafa, z. Sokol Ibi, z. Valbon Çekrezi, znj. Vojsava Osmanaj, znj. Altina Nasufi dhe znj. {...}.

### **C. PROCEDURA E VERIFIKIMIT**

10. Procedura e verifikimit të plotësimit të kritereve të kandidimit nga kandidatët për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 535, datë 17.11.2021, filloi me Vendimin e tij nr. 26, datë 17.01.2022.

11. Fillimisht, sikurse u përmend në pikën 6, të këtij vendimi, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga secili kandidat të kritereve formale të kandidimit, pikërisht të:

- 1) *“përvojës profesionale minimale”*, sipas pikës 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: *“Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. ...”*, si dhe pikës 5, të nenit 47, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“5. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë*

*në pozicione pranë Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”;*

- 2) *“mospasjes masë disiplinore në fuqi”*, sipas pikës 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“8. Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”;*
- 3) *“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”*, sipas nenit 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“1. Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë. 2. Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, efikasiteti dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë. 3. Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni; ... 5. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, magjistrati, në momentin e paraqitjes së kërkesës për ... ngritje në detyrë, paraqet një vetëdeklarim përpara Këshillit, ku deklaron nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni. ...”.*

12. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak të tre kritereve formale të kandidimit, Këshilli konstatoi dhe vlerësoi plotësimin vetëm nga katër kandidatë<sup>1</sup> të këtyre kritereve, duke vendosur vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

13. Verifikimi i plotësimin nga kandidatët të tre kritereve formale të kandidimit, u vendos nga Këshilli: me Vendimin nr. 92, datë 09.03.2022, për kandidaten znj. {...}; me Vendimin nr. 96, datë 09.03.2022, për kandidaten z. Valbon Çekrezi dhe me Vendimin nr. 91, datë 09.03.2022, për kandidaten znj. Altina Nasufi.

13.1 Për kandidatin z. Sokol Ibi, i cili ka kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, referuar vendimit nr. 26, datë 17.01.2022, procedura e përfunduar e verifikimit për këto kandidime sa i përket kritereve të përvojës profesionale minimale, pasurisë dhe figurës, është konsideruar e vlefshme edhe për kandidimin e tij për ngritjen në detyrë në këtë gjykatë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

13.2 Për kandidaten Vojsava Osmanaj, Këshilli me vendimin nr. 105, datë 25.03.2022, vendosi: *“Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me Vendimin nr. 535, datë 17.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. Vojsava Osmanaj, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion”.*

---

<sup>1</sup> Z. Sokol Ibi, z. Valbon Çekrezi, znj. Altina Nasufi dhe znj. {...}

13.3 Lidhur me kandidimin e z. Arjan Qafa, me vendimin nr. 50, datë 08.02.2022, Këshilli vendosi *skualifikimin dhe përjashtimin e tij nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë*, në kushtet kur për të u verifikua mosplotësimi i kriterit të *“mospasjes masë disiplinore në fuqi”*, ndërsa ndaj kandidatit ishte dhënë masa disiplinore *“shkarkim nga detyra”*, me vendimin nr. 298, datë 17.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ndaj këtij vendimi, kandidati paraqiti ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, ndërkohë që kjo e fundit me vendimin nr. 37, datë 01.06.2022 vendosi rrëzimin e padisë.

14. Në vijim, Këshilli verifikoi plotësimin nga secili kandidat edhe të kriterëve *“të pasurisë dhe figurës”*, sipas pikave 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji”*, si dhe: *“8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”*.

15. Sa më sipër, në përfundim të procedurës së verifikimit, Këshilli konstatoi dhe vlerësoi plotësimin nga katër prej gjashtë kandidatëve të të gjithë kriterëve të kandidimit, duke vendosur kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë/emërimit në Gjykatën e Lartë.

16. Kualifikimi i kandidatëve dhe vijimi për ata të procedurës së ngritjes në detyrë/emërimit në Gjykatën e Lartë, u vendos nga Këshilli: me Vendimin nr. 174, datë 05.05.2022, për kandidatin z. Valbon Çekrezi; me Vendimin nr. 130, datë 06.04.2022, për kandidaten znj. Altina Nasufi, me Vendimin nr. 129, datë 06.04.2022, për kandidaten znj. {...} dhe me Vendimin nr. 115, datë 29.03.2022, për kandidatin z. Sokol Ibi.

### **Ç. PROCEDURAT E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL**

17. Nga ana tjetër, siç u parashtrua, krahas procedurave të verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidatët kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht: 1) Procedura e vlerësimit me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar), referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit për Statusin, filluar me Vendimet e Këshillit nr. 41, datë 04.02.2021 dhe nr. 22, datë 17.01.2022; 2) Procedura e vlerësimit të përshpejtuar për vitin 2021, filluar me Vendimin e Këshillit nr. 118, datë 29.03.2022 (për kandidatët znj. Altina Nasufi, znj. {...} dhe z. Valbon Çekrezi)<sup>2</sup>.

18. Në përfundim të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional, Këshilli ka miratuar për secilin nga katër kandidatët, vlerësimet etike dhe profesionale për periudhat respektive të vlerësimit. Kështu, për kandidaten znj. Altina Nasufi, vlerësimet etike dhe profesionale u miratuan me Vendimet e Këshillit nr. 536, datë 14.12.2022 dhe nr. 537, datë 14.12.2022. Për kandidaten znj. {...}, vlerësimet etike dhe profesionale u miratuan me Vendimet e Këshillit nr. 4, datë 16.01.2023 dhe nr. 161, datë 06.04.2023. Për kandidatin z. Valbon Çekrezi, vlerësimet etike dhe profesionale u miratuan me Vendimet e Këshillit nr. 456, datë 02.11.2022 dhe nr.3, datë 16.01.2023. Ndërsa për kandidatin z. Sokol Ibi, vlerësimet etike dhe profesionale u miratuan me Vendimet e Këshillit nr. 196 dhe nr. 197, datë 12.05.2021.

---

<sup>2</sup> Ndërkohë, për kandidatin z. Sokol Ibi, vlerësimi kishte filluar dhe përfunduar më herët, si pasojë e kandidimeve të tij të mëhershme

## D. PROCEDURA E PËRZGJEDHJES

19. Ndërsa procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve vijonin, për përfundimin në kohë të procedurës tërësore të ngritjes në detyrë, propozimit për emërim në Gjykatën e Lartë, edhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e tij nr. 535, datë 17.11.2021, Këshilli filloi procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve me Vendimin nr. 193, datë 27.05.2022.

19.1 Gjatë vijimit të procedurës së përzgjedhjes, njëri nga kandidatët, z. Sokol Ibi, paraqiti kërkesë për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e përzgjedhjes, kërkesë e cila u miratua me vendimin nr. 258, datë 15.07.2022 të Këshillit. Me anë të këtij vendimi, Këshilli vendosi përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 për kandidatin z. Sokol Ibi.

20. Procedura e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 535, datë 17.11.2021, ka vijuar për të tre kandidatët e mbetur, për të cilët ishte verifikuar plotësimi i dy kërkesave të ligjit për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, në kushtet kur ata ishin kualifikuar në procedurën e ngritjes në detyrë/emërimin ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit, si dhe kishin dy vlerësime etike dhe profesionale, sikurse kërkohet për efekt renditje nga shkronja “a”, pika 9, e nenit 48, të Ligjit për Statusin dhe përcaktohet në shkronjën “c”, pika 7 dhe në pikën 46, të Vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

21. Në përfundim të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 535, datë 17.11.2021, bazuar në kriteret e renditjes të përcaktuara në pikën 9, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara më tej në Vendimin e Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, dalë në zbatim të pikës 14, të nenit 48, të këtij ligji, Këshilli realizoi renditjen e kandidatëve, duke identifikuar edhe kandidatin, i cili, sipas ligjit, duhet të propozohet për emërim. Konkretisht, me Vendimin nr. 212, datë 28.04.2023, Këshilli miratoi Vendimin Paraparak të Propozimit për Emërim duke vendosur:

*“1. Miratimin e renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:*

- 1) znj. {...};*
- 2) znj. Altina Nasufi dhe z. Valbon Çekrezi;*

*2. Propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të kandidatës znj. {...}”.*

22. Lidhur me propozimin paraparak për emërim të znj. {...}, sipas Vendimi Paraparak i Propozimit për Emërim nr. 212, datë 28.04.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka mbajtur në konsideratë parashikimin e pikës 12, të Vendimit 70/2020, ku përcaktohet se: “12. Rënditja e kandidatëve

*bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kandidati me nivelet më të larta të vlerësimit etik dhe profesional, renditet më lart.”*

22.1 Referuar përparësisë së parë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “nivelet të vlerësimit të fundit”, nisur nga sa më lart u parashtrua, për kandidatët u konstatua që kanë nivel të ndryshëm vlerësimi, konkretisht znj. {...} ka nivel vlerësimi, “Shkëlqyeshëm”, për të dy vlerësimet etiko – profesionale, ndërsa dy kandidatët e tjerë kanë nivel “Shkëlqyeshëm”, për njërin vlerësim dhe nivel “Shumë mirë”, për vlerësimin tjetër. Për pasojë, renditja e kandidatëve mund të bëhet sipas kësaj përparësie. Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 535, datë 17.11.2021, ku më lart renditet kandidatja znj. {...}, ndërsa kandidatët e tjerë renditen pas saj, duke mos patur rëndësi për këtë procedurë përzgjedhjeje renditja mes tyre e kandidatëve të tjerë, pra e kandidatëve me nivele vlerësimi të njëjta më të ulta, znj. Altina Nasufi dhe z. Valbon Çekrezi.

22.1 Nisur nga këto rrethana, si dhe shprehjen e preferencës nga ana e znj. {...}, e cila me vullnetin e saj shpreh si preferencë të parë, preferencën për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 (megjithëse ajo ka kandiduar edhe për dy pozicione në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021), Këshilli vendosi duke marrë parasysht zbatimin e preferencës së parë të kandidatës.

22.4 Sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka arritur në përfundimin se për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative në Gjykatën e Lartë, të shpallur me Vendimin e tij nr. 535, datë 17.11.2021, duhet të propozohet kandidatja e renditur e para sipas nivelit të vlerësimit etiko-profesional, pikërisht znj. {...}.

23. Vendimi i arsyetuar sipas pikës 21, të këtij vendimi, iu njoftua rregullisht, më datë 04.05.2023, në rrugë elektronike, kandidatëve znj. {...}; znj. Altina Nasufi dhe z. Valbon Çekrezi, të cilët, bazuar në pikën 12, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, gëzonin të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi, brenda 5 ditëve, nga njoftimi i tij. Gjithashtu, ky vendim ju është njoftuar në mënyrë shkresore të tre kandidatëve, të cilët rezultojnë të kenë marrë dijeni në rrugë postare, përmes dokumentit “lajmërim marrje” më datë 04.05.2023.

24. Sa i përket të drejtës së ankimit të vendimit, për kandidatët znj. {...}; znj. Altina Nasufi dhe z. Valbon Çekrezi, rezultojnë që: (i) znj. {...} përmes komunikimit elektronik të datës 28.04.2023 ka marrë dijeni mbi vendimin dhe ka deklaruar se nuk ka ankim ndaj tij; (ii) znj. Nasufi ka ankimuar vendimin pranë Gjykatës Administrative të Apelit, e cila me vendimin nr. 28, datë 19.05.2023 ka vendosur rrëzimin e kërkesës, për pasojë konsiderohet që ky vendim ka marrë formë të prerë; dhe (iii) z. Çekrezi nuk rezultojnë të ketë paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 212, datë 28.04.2023 (referuar informacionit të dërguar nga Gjykata Administrative e Apelit përmes komunikimit elektronik të datës 23.05.2023, protokolluar pranë Këshillit me nr. 2999 prot., datë 23.05.2023). Për pasojë, Vendimi Paraprak i Propozimit për Emërim nr. 212, datë 28.04.2023, mori formë të prerë sipas ligjit, duke u shndërruar kështu në vendim përfundimtar.

### **III.MBI PLOTËSIMIN E KRITEREVE TË KANDIDIMIT/EMËRIMIT NË GJYKATËN E LARTË, NGA KANDIDATJA ZNJ. {...}**

25. Siç u parashtrua, plotësimi i kriterëve të kandidimit nga kandidatja znj. {...}, u verifikua nga Këshilli me Vendimin nr. 92, datë 09.03.2022 (*për tre kriteret formale të kandidimit*) dhe, më pas, edhe me Vendimin final nr. 129, datë 06.04.2022.

26. Konkretisht, për kandidaten znj. {...} është verifikuar plotësimi i kriterit të "*përvojës minimale profesionale*". Për verifikimin e këtij kriteri janë administruar: Shkresa nr. 264/1 prot., datë 21.01.2022, e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, Shkresa nr. 701/1 prot., datë 02.02.2022, nr. 701/2 prot., datë 07.02.2022 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Shkresa nr. 331 prot., datë 02.02.2022 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

26.1 Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se kandidati plotëson përvojën e përgjithshme minimale profesionale, ndërsa ajo ka ushtruar funksionin e gjyqtarës për më shumë se 13 vjet. Evidentohet se kandidatja znj. {...}, me vendim nr. 1, datë 30.03.1995 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet Ndhmësgjyqtar efektiv në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekret nr. 2626, datë 13.05.2000 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Me vendim nr. 260, datë 01.04.2010 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë transferohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekret nr. 9461, datë 15.03.2016 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Me procesverbal datë 09.07.2021 zgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, funksion të cilin mban edhe aktualisht.

26.2 Po për kriterin e "*përvojës minimale profesionale*", nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se kandidatja plotëson edhe përvojën specifike minimale profesionale, ndërsa ajo ka ushtruar funksionin e gjyqtarës në fushën e të drejtës administrative, për më shumë se 5 vjet, ndërsa më së paku, prej muajit mars 2016 e në vijim, përvoja profesionale e kandidates është vetëm në fushën e të drejtës administrative.

27. Për kandidaten znj. {...} është verifikuar plotësimi edhe i kriterit të "*mospasjes masë disiplinore në fuqi*". Për verifikimin e këtij kriteri janë administruar: Shkresa 264/1 prot., datë 21.01.2022, e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Formulari i Vetëdeklarimit "Për masa disiplinore", datë 13.12.2021, depozituar nga kandidati në momentin e kandidimit, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: "*Nuk kam masë disiplinore në fuqi*".

27.1 Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se kandidatja nuk ka masë disiplinore në fuqi.

28. Për kandidaten znj. {...} është verifikuar plotësimi edhe i kriterit të "*mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale*". Për verifikimin e këtij kriteri është administruar Formulari i Vetëdeklarimit "Për situatën e papajtueshmërisë ambientale", datë 13.12.2021, depozituar nga kandidati në momentin e kandidimit për herë të parë, ku ka deklaruar se "*Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar*".



28.1 Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se kandidatja nuk do të ndodhej në situatën e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit për Statusin, nëse do të ngrihej në detyrë/emërohej në Gjykatën e Lartë.

29. Për kandidaten znj. {...} është verifikuar plotësimi edhe i kriterëve të “pasurisë” dhe të “figurës”.

29.1 Për këto kriterë, në nenin 48, pikat 7 dhe 8, të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: “7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. 8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”. Ky përcaktim ligjor në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për ngritjen në detyrë, ndër të tjera, edhe në Gjykatën e Lartë, është rregulluar më tej në aktin nënligjor të Këshillit, Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar. Pasur parasysh faktin se të gjithë gjyqtarët në detyrë, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë subjekt rivlerësimi kalimtar “*ex officio*”, rivlerësim ky që përfshin edhe verifikimin e pasurisë dhe figurës, Këshilli parashikoi rregulla specifike për gjyqtarët subjekt rivlerësimi kalimtar që kandidonin për ngritjen në detyrë, sa i përkiste verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. Kështu, në këtë akt nënligjor, Këshilli parashikoi rregulla specifike edhe për gjyqtarët që kandidonin për ngritjen në detyrë, të cilët i ishin nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 dhe ishin konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë. Konkretisht, në Seksionin B, Kreu X, të tij, përcaktohet se: “1. Kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. ... 4. Procedura e përcaktuar në pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, ..., për kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, shtrihet për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar”. Sa sipër, kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për t’u kualifikuar për ngritjen në detyrë, do të duhet në çdo rast të kalojë me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sikundër edhe procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas nenit 32 të Ligjit për Statusin, kjo për periudhën pas asaj të rivlerësimit kalimtar dhe deri në momentin e kandidimit.

30. Për verifikimin e kriterit të “pasurisë” janë administruar: Vendimi nr. 376, datë 26.04.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka marrë formë të prerë pa u ankimuar; Akti i Përfundimit të Kontrollit të Plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Private të Kandidatit për Institucionet e Sistemit të Drejtësisë nr. 723/24 prot., datë 24.03.2022, i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Interesave Privatë; Shkresa nr. 3484/1 prot., datë 21.02.2022, e Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve dhe Shkresa nr. 2818/1 prot., datë 01.03.2022, e Drejtorisë së Përgjithshme e Doganave.

30.1 Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se kandidatja ka kaluar me sukses, me vendim të formës së prerë, procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, referuar për këtë Vendimit nr. 376, datë 26.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

30.2 Po ashtu, për këtë kriter, sa i përket periudhës pas asaj të rivlerësimit kalimtar dhe deri në momentin e kandidimit, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se: a) *kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë; b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë; c) kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e tij; ç) deklarimi nga kandidati i pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t’u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.*

31. Për verifikimin e kriterit të “*figurës*” janë administruar: shkresat nga shërbimet shtetërore informative; Shkresa nr. 836/2 prot., datë 15.02.2022, e strukturës së posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Vendimi nr.69, datë 15.03.2022, i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

31.1 Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar, sikurse u përmend, është konstatuar se kandidatja ka kaluar me sukses, me vendim të formës së prerë, procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

31.2 Po ashtu, për këtë kriter, sa i përket periudhës pas asaj të rivlerësimit kalimtar dhe deri në momentin e kandidimit, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se për kandidatin nuk identifikohet dhe verifikohet ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

31.3 Në vijim, për këtë kriter, në kushtet kur kandidatja ka qenë magjistrat/gjyqtare në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ky ligj, kandidatja i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji. Struktura e posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka konfirmuar se: - *ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 03.05.2016; nga struktura e posaçme ka marrë numër rendor 000361; - formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të ëeb; - në formularin e vetëdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji; - nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nuk ka rezultuar ndryshime të dhënave të gjendjes civile apo gjendjes gjyqësore, nga ato të deklaruara; - deri më sot nuk ka pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.*

31.4 Po për këtë kriter, kandidati i është nënshtruar verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, në kushtet kur ajo është e vitlindjes më të hershme se Korrik 1977 (kandidatja është e vitlindjes 1972). Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me Vendimin nr.69 datë 15.03.2022, ka vendosur: “*Të informojë institucionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 866/7 prot., datë 10.02.2022, “Kërkesë për verifikim”, të pastërtisë së figurës, përpara emërimit të kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, se nga verifikimet e kryera deri tani për znj. {...} nuk rezultojnë: a) të ketë qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991, në zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas përcaktimeve të nenit 29 të Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.*”

31.5 Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se: a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015; b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit të Statusit, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij; c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; ç) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit, përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar; d) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës; dh) për kandidatin nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e tij, mbi të cilat mund të gjykohej për papranueshmërinë e tij për emërim në Gjykatën e Lartë.

#### **IV. KONKLUZIONE**

32. Sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se kandidatja znj. {...}, në kushtet kur plotëson kriteret e kandidimit për emërim në Gjykatën e Lartë, ndërsa është kandidatja e rënditur e para sipas kriterit të “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e tij nr. 535, datë 17.11.2021, duhet t’i propozohet Presidentit të Republikës për t’u emëruar gjyqtare në Gjykatën e Lartë.

33. Për arritjen në përfundimin si më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbajti në konsideratë edhe faktin se Vendimi Paraprak i Propozimit për Emërim nr. 212, datë 28.04.2023, pas njoftimit rregullisht kandidatëve respektivë, të cilët gëzonin të drejtën e ankimit ndaj tij, u shndërrua në vendim përfundimtar, në kushtet kur: (i) znj. {...} përmes komunikimit elektronik të datës 28.04.2023 ka marrë dijeni mbi vendimin dhe ka deklaruar se nuk ka ankim ndaj ti; (ii) znj. Nasufi ka ankimuar vendimin pranë Gjykatës Administrative të Apelit, e cila me vendimin nr. 28, datë 19.05.2023 ka vendosur rrëzimin e kërkesës, për pasojë konsiderohet që ky vendim ka marrë formë

të prerë; dhe (iii) z. Çekrezi nuk rezulton të ketë paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 212, datë 28.04.2023 (referuar informacionit të dërguar nga Gjykata Administrative e Apelit përmes komunikimit elektronik të datës 23.05.2023, protokolluar pranë Këshillit me nr. 2999 prot., datë 23.05.2023).

### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në pikën 1, të nenit 136, në nenin 147 dhe në shkronjën “c”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 2, të nenit 85 dhe në shkronjën “ç”, “ë”, të nenit 86, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 11, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun IX, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

### **VENDOSI:**

1. T’i propozojë Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatës znj. {...}.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**